

## NJOFTIM

Sot, më datë **20.06.2023, ora 09:30**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Blerona Hasa (Relatore);**
- 2. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 3. Alma Kolgjoka (Anëtare);**
- 4. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 5. Emona Muçi (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.32 Regj.Themeltar, Datë 12.06.2023 Regjistrimi, me:

**PADITËS:** Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga Av. Franci Nuri dhe Av. Blendi Himçi.

**I PADITUR:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – KQZ, përfaqësuar nga Znj. Ina Osmanaj dhe Znj. Daniela Alimemeti.

**PERSON I INTERESUAR:** Subjekti Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Av. Maringlen Legisi.

**OBJEKTI:** Ndryshimin e Vendimit nr.177, datë 08.06.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur: Prishjen e Vendimit të KSHZ nr.539, datë 20.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në Zonën Zgjedhore Bashkia Elbasan, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023”, duke vendosur:

- (i) Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Elbasan; dhe
- (ii) Përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Elbasan me anë të votimit tradicional me fletë votimi fizike.

**BAZA LIGJORE:** Neni 3/1, Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ; Nenet 4, pika 1, Nenet 9, Neni 45, Neni 46 e vijues të Kushtetutës së Shqipërisë, Nenet 63, 64, 65, 98, Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit, si dhe nenet 136, 139, 145 e vijues i Kodit Zgjedhor.

me Vendimin Nr. 32, datë 20.06.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimisht,

## **VENDOSI**

1. Rrëzimin e kerkesëpadiisë.
2. Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës paditëse.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë më datë 20.06.2023.

**Tiranë, më 20.06.2023**

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**